



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:164548

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05768079

C.nr.506/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.O nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati A.B nga Rahoveci, ndaj të paditurit Sh.H nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati G.Sh nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jo material, me vlerën e objektit të kontestit prej 9.000 euro, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 21.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësit L.O nga Rahoveci.

II. DETYROHET i padituri Sh.H nga Rahoveci, që paditësit L.O në emër të dëmit jo material ta kompensojë dhe atë:

- Në emër të dhimbjeve fizike.....3,000.00 euro.
- Në emër të frikës së përjetuar.....2,500.00 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 5,500.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, e në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit L.O, përtej shumës së aprovuar si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

IV. DETYROHET i padituri Sh.H, që paditësit L.O, t’ia paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 763.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi L.O nga Rahoveci, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 24.11.2020 në këtë gjykatë ka parashtruar padinë ndaj të paditurit Sh.H nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material dhe jo material, me vlerën e objektit të kontestit prej 9.000 euro, e precizuar në seancën e datës 21.05.2024.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij av. A.B, në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. I njëjti ka theksuar se me datën 29.08.2020, rreth orës 11:40, me dashje i padituri Sh.H nga Rahoveci i

shkakton lëndime trupore L.O, ku fillimisht fillon të bërtas në drejtim të tij e më pas e godet me grushte në fytyrë, përderisa i dëmtuari ishte i ulur në veturën e tij. Duke shtuar se pasi që kemi të bëjmë me lëndime trupore, ku i njëjti nga këto lëndime trupore ka pësuar frikë, gjykatës i ka propozuar që për seancën e radhës të caktoj mjekët nga lëmia përkatëse dhe atë mjekun ortoped dhe mjekun psikiatër, që të njëjtit të përcaktojnë se çfarë lloje të lëndimeve dhe frikës ka përjetuar këtu paditësi. Po ashtu ka theksuar se në bazë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor padyshim është vërtetuar kërkesëpadia e paditësit dhe si e tillë ka mbështetje ligjore, ku duhet të aprovohet, meqenëse është konstatuar që paditësi ka pësuar nga i padituri lëndime të rënda trupore, me zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, sipas BQK-së, ku për humbjen e një dhëmbi kemi humbje të aktivitetit 1%. I njëjti ka deklaruar se sa i përket precizimit të kërkesëpadisë për paditësin L.O, që është lënduar nga Sh.H, për dhimbje fizike kërkojnë shumën 5,000.00 Euro, ndërsa për frikën shumën prej 4,000.00 Euro, në shumën e përgjithshme prej 9,000.00 Euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar av. G.Sh, në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshtojnë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, për faktin se provat e propozuara, nuk janë prova të qarta, e as që janë të protokolluara në librat e protokollit, nga ana e Shtëpisë së Shëndetit në Rahovec. Duke shtuar se sidomos receta për barna, e lëshuar nga Dr. A.B, nuk ka as datë e as protokollim. Po ashtu shënimet e pacientit nga receta për barna, e lëshuar nga Dr. L.K, përveç që shënon terapia “paracetamol tableta” dhe as një konstatim tjetër për pacientin, kinse ka pasur lëndime trupore, siç pretendon pala paditëse. Gjykatës ia ka propozuar që zyrtarisht të kërkojë nga Shtëpia e Shëndetit në Rahovec, që të vërtetohen këto dy receta për barna apo ndonjë tretman tjetër, si dhe konstatimin lidhur me lëndimet trupore për datë 29.08.2020. Sa i përket raportit të mjekut specialist, të Dr. H.SH, nuk ka lidhje kauzale në mes të raportit apo recetës së barnave të cilën e ka prezantuar pala paditëse, për faktin se ka pasur nevojë që të i rregullojë dhëmbët te stomatologu. I njëjti ka theksuar se sa i përket ekspertizës psikiatrike, kanë vërejtje, për shkak se eksperti nuk është bazuar në kriteret, gjegjësisht standardet që kërkojnë për të vlerësuar mendimin profesional gjë që kjo është në kundërshtim me raportin bazë (recetë për barna), që ka prezantuar pala paditëse. Duke shtuar se kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, për faktin se nga provat e propozuara, e të cilat prova nuk janë të qarta, e as që janë të protokolluara, po ashtu nuk dihet se nga kush janë lëshuar raportet bazë, gjegjësisht a janë institucionet shtetërore apo janë ordinanca private. Ndërsa ekspertizat e ekspertëve as që janë bazuar në raportin bazë, pasi aty kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore, ndërsa në konstatimet e tilla po del që kemi të bëjmë me lëndime trupore të rënda. Andaj, nga kjo rezulton që kemi të bëjmë me prova që janë kontradiktore dhe si të tilla nuk mund të jenë bindëse për gjykatën. Nga kjo bazë dhe nga ky fakt mund të konstatohet se nuk ka lidhje kauzale, për shkak se mungojnë datat dhe shënimet plotësuese për paditësin. Po ashtu, sa i përket precizimit të padisë nga përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, nuk mund ta quajmë precizim bazik, për faktin se nuk i plotëson kushtet e dispozitës ligjore. Duke shtuar se i kundërshton edhe shpenzimet e procedurës të cilat i ka kërkuar përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse dhe shumën e kërkuar për lëndimin e pësuar. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv, konform nenit 258.2 të LPK-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 21.05.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: Recetën për barna, me nr. serik 03869, e datës 29.08.2020, me faksimil të Dr. L.K; recetë për barna, pa datë, me faksimil të Dr. A.B t; raportin e mjekut specialist, i lëshuar nga H i datës 29.08.2020, me faksimil të Dr. H.SH, kirurg maksilofacial; faturën, e lëshuar nga A me seli në Suharekë dhe me faksimil të Dr. A.B t; foto bardhë dhe zi e CD-së, datë 29.08.2020, e lëshuar nga “H në Rahovec; 3 kuponë fiskalë; Aktgjykimin me numër P.nr.235/2020, i Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec, i datës 02.11.2020, i plotfuqishëm nga data 20.11.2020; ekspertizën mjeko-ligjore ortopedike-traumatologjike, e dorëzuar nga eksperti Dr. I.S, me datë 20.02.2024 dhe ekspertizën psikiatrike, e dorëzuar me datë 11.03.2024, nga eksperti Dr. N.F.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 7 dhe 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore kontestuese është baza juridike e kërkesëpadisë si dhe lartësia e kërkesës.

Me administrimin e recetës për barna, me nr. serik 03869, e datës 29.08.2020, me faksimil të Dr. L.K, gjykata ka vërtetur faktin se paditësi L.O, si pasojë e lëndimit ka pranuar tretman mjekësor, në ditën kur ka ndodhur mosmarrëveshja ndërmjet tij dhe të paditurit Sh.H.

Me administrimin e raportin e mjekut specialist, i lëshuar nga H i datës 29.08.2020, gjykata ka vërtetur faktin se paditësi L.O në ditën kur ka ndodhur mosmarrëveshja ndërmjet tij dhe të paditurit Sh.H, po ashtu ka pranuar tretman mjekësor nga kirurg maksilofacial Dr. H H. Sh.

Me administrimin e faturës, e lëshuar nga A, me seli në Suharekë dhe me faksimil të Dr. A.B t, gjykata ka vërtetur faktin se paditësi L.O, ka bërë implant të dhëmbit, ndërsa për këtë shërbim i njëjti ka paguar shumën prej 350.00 euro.

Me administrimin e aktgjykimit me numër P.nr.235/2020, i Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec, i datës 02.11.2020, i plotfuqishëm nga data 20.11.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri Sh.H, është shpallur fajtor për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar. 1.4 të KPRK-së, të kryer ndaj të dëmtuarit, këtu paditësit L.O.

Me administrimin e 3 kuponë fiskalë, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka vërtetuar faktin se shpenzimet e mjekimit të paditësit arrijnë shumën prej 196.00 euro.

Me administrimin e ekspertizën mjeko-ligjore ortopedike-traumatologjike, e dorëzuar nga eksperti Dr. I.S, me datë 20.02.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se duke u bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës paditësi L.O ka pësuar këto lëndime trupore: Humbjen

e një dhëmbi, i cili sipas rregullores së BQK-së, karakterizohet si lëndim i rëndë trupor, si dhe lëndimin e buzës. Po ashtu është konstatuar se në momentin e pësimit të lëndimit paditësit i janë shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rënda të cilët kanë zgjatur 15 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të cilët kanë zgjatur për 6 orë, kohë pas kohe deri në marrjen terapisë kundër dhimbjes, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 3 ditë kohë pas kohe deri në marrjen terapisë kundër dhimbjes, dhimbje fizike e intensitetit të lehtë e cila ka zgjatur 15 ditë. Po ashtu është konstatuar se shëmtim trupor nuk ka. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor sipas BQK-së, për humbjen e 1 (një) dhëmbi është 1%. Ndihma e personit tjetër nuk ka qenë e nevojshme, ndërsa ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm deri në 21 ditë në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasuar me proteina, minerale dhe vitamina. Rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik nuk ka qenë i nevojshëm.

Gjykata ka ftuar ekspertin e ortopedisë –traumatologjisë Dr. I.S, në seancën e datës 21.05.2024, i cili në këtë seancë ka deklaruar se qëndron pranë ekspertizës së punuar, ndërsa duke u përgjigjur në pyetjet e përfaqësuesit të autorizuarit të të paditurit, i njëjti ka theksuar në bazë të shkresave të lëndës dhe ekzaminimit të paditësit e ka dhënë mendimin sikurse në ekspertizë. Pretendimeve të autorizuarit të të paditurit se deri te konstatimi si në ekspertizë, ka ardhur sipas dy raporteve, ndërsa në fakt ato janë receta për barna, si dhe a ka vërejtur eksperti ndonjë konstatim që ka të bëjë me ndonjë lëndim, i njëjti është përgjigjur se raporti i datës 29.08.2020 nuk quhet recetë, por raport i mjekut specialist nga H, në Rahovec, me logo të institucionit, datë dhe nënshkrim të mjekut, që janë kushtet që sipas BQK-së, që duhet të bazohet ekspertiza, qoftë institucion shtetëror ose privat, por i licencuar. Ndërsa lidhur me konstatimin e tij në ekspertizë, sa i përket lëndimit të rëndë trupori, i njëjti ka sqaruar se humbja e një dhëmbi është 1% zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm mjekësor dhe ky lëndim karakterizohet si lëndim i rëndë trupor, sipas rregullores së BQK-së, si dhe ky mendim është bazuar sipas rregullores së BQK-së dhe nuk është mendim personal i tij. Lidhur me pyetje se a ka mundësi që të thuhet dhëmbi, pa pasur shenja në fytyrë, eksperti ka sqaruar se në rastin konkret ka pasur lëndim të buzës, në recetën e mjekut LK, datë 29.08.2020, ku shkruan: “Vulnus regio labi”, që përkthyer në shqip nga latinishtja është: “Plagë në regjionin e buzës”. Sipas shkresave të gjykatës dhe në konstatimin të kanë qenë dy lëndime, humbja e një dhëmbi dhe lëndimi i buzës.

Me administrimin e ekspertizën psikiatrike, e dorëzuar me datë 11.03.2024, nga eksperti Dr. N.F gjykata ka vërtetuar faktin se duke u bazuar në raportet mjekësore që gjenden në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit me datën 29.02.2024, paditësi L.O, me datë 29.08.2020, në momentin e lëndimit ka përjetuar: frikë të intensitetit të lartë në dy javët e para pas sulmit, e cila është shfaqur në formë të shfaqjes së emocioneve negative si frikë, pasiguri, brengosje, mërzitje, pagjumësi, mendime negative, ëndrra të këqija, parashikimet negative që kanë sjellur edhe shmangie nga aktiviteti i zakonshëm. Frikë e intensitetit të mesëm ka vazhduar për tre javë me një prezencë të kohëpaskohshme të frikës, pasigurisë, brengosjes, mërzitjeve, kujtimeve traumatike të rastit dhe mendimeve negative. Frikë e intensitetit të ulët ka vazhduar rreth 6 muaj me një prezencë të stresit të tepruar, ndjeshmërisë emocionale, parashikimeve negative dhe disponimit të ulur.

Gjykata ka ftuar ekspertin e psikiatrisë Dr. N.F, në seancën e datës 25.04.2024, i cili në këtë seancë ka deklaruar se qëndron pranë ekspertizës së punuar, ndërsa duke u përgjigjur në pyetjet

e palëve ndërgjyqëse, i njëjti ka theksuar në bazë të shkresave të lëndës dhe ekzaminimit e paditësit e ka dhënë mendimin sikurse në ekspertizë. Mbi i çfarë baze ka marrë një konstatim të tillë eksperti, kur është fjala për intensitetin e frikës (të lartë, të mesëm dhe të ulët), eksperti ka sqaruar se mendimi i tij është bazuar në aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë-Dega në Rahovec, dokumentacionin mjekësor që ka pasur pala paditëse, si dhe ekzaminimit psikiatrik që ka kryer me datë 29.02.2024. I njëjti ka sqaruar se është konstatuar se nuk ka ndonjë raport psikiatrik të lidhur me këto shqetësime të palës paditëse, që i bie se kjo është bazuar në faktet e sulmit fizik, si dhe në përjetimet e shprehura të palës paditëse gjatë ekzaminimit psikiatrik dhe bazuar në atë, që nga ana profesionale dinë për natyrën e frikës dhe përjetimeve të një personi. Ndërsa a është bazuar konstatimi i eksperti në dy receta për barna, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, eksperti ka sqaruar se nuk është me rëndësi se në recetë është shkruar paracetamol apo jo, sepse nuk kam bërë përcaktimin e përjetimit të dhimbjes, por ka bërë përcaktimin e përjetimit të frikës. Duke shtuar se edhe në ekspertizë e ka cekur se nuk ka një dokumentacion mjekësor që paditësi ka marrë trajtim psikiatrik, por kjo nuk e mohon përjetimin e frikës nga një person, pasi siç e dihet në rastet kur ndodh një sulm fizik dhe sidomos një lëndim trupor, te një person, mekanizimi psikologjik i tij, reagon me ankth, frikë, brengosje se çfarë do të ndodh me të në të ardhmen, të cilat shqetësime ia çrregullojnë funksionimin e përditshëm dhe kjo është ajo baza e përjetimit të frikës që kam përcaktuar. Lidhur me pyetjen përfaqësuesit të autorizuarit të të paditurit se në cilat raste pacienti përjeton frikë të intensitetit të lartë, në 2 javët e para pas sulmit, me pretendime se në bazë të raporteve nuk ka asnjë konstatim se pacienti këtu paditësi, ka pësuar lëndime trupore, eksperti ka sqaruar se përjetimi i frikës në rastet e sulmeve fizike, por edhe traumave të tjera është individual dhe bazohet në kapacitetet psikologjike që i ka një person për të u ballafaquar me një kërcënim për jetën. I njëjti ka sqaruar edhe pse ka konstatuar se nuk ka ndonjë raport psikiatrik të lidhur me këto shqetësime, mirëpo kjo nuk e mohon përjetimin e frikës nga pala paditëse në këtë rast.

Gjykata të dy ekspertizat i vlerëson të hartuar dhe argumentuar mirë dhe në mënyrë profesionale, pasi që mendimet sqarimet e tyre në seancat e shqyrtimit kryesor janë dhënë duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit e paditësit, andaj të njëjtat i pranoj të besueshëm dhe të njëjtave ia fali besimin në plotësi.

Gjykata vendosi ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit për faktin se sipas vlerësimit të saj në këtë çështje juridike kontestimore kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit jo material, si pasoj e lëndimit të paditësit L.O me datë 29.08.2020, i shkaktuar nga i padituri Sh.H. Baza juridike e kërkesëpadisë buron nga neni 136 i LMD-së, ku parashihet se *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa neni 140 e të njëjtit ligj parasheh se *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*. Baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar me aktgjykimin P.nr.235/2020 i Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega në Rahovec, i datës 02.11.2020, i plotfuqishëm nga data 20.11.2020, me të cilin i padituri është shpallur fajtor dhe me ekspertizën e ekspertit Dr. I.S, të dorëzuar në këtë gjykatë më datën 20.02.2024, sipas të cilës është konstatuar me rastin e shkaktimit të lëndimit, paditësi L.O ka pësuar këto lëndime trupore: humbjen e një dhëmbi, i cili sipas rregullores së BQK-së, karakterizohet si lëndim i rëndë trupor, si dhe lëndimin e buzës. Po ashtu është konstatuar se në momentin e pësimit të lëndimit i janë

shkaktuar: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rënda të cilët kanë zgjatur 15 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të cilët kanë zgjatur për 6 orë, kohë pas kohe deri në marrjen terapisë kundër dhimbjes, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 3 ditë kohë pas kohe deri në marrjen terapisë kundër dhimbjes, dhimbje fizike e intensitetit të lehtë e cila ka zgjatur 15 ditë. Ndihma e personit tjetër nuk ka qenë e nevojshme, ndërsa ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm deri në 21 ditë në kuptim të përzgjedhjes së ushqimit të pasuar me proteina, minerale dhe vitamina. Po ashtu Baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar me ekspertizën psikiatrike, e dorëzuar me datë 11.03.2024, nga eksperti Dr. N.F, sipas së cilës është konstatuar se në momentin e lëndimit paditësi L.O ka përjetuar: frikë të intensitetit të lartë në dy javët e para pas sulmit, e cila është shfaqur në formë të shfaqjes së emocioneve negative si frikë, pasiguri, brengosje, mërzitje, pagjumësi, mendime negative, ëndrra të këqija, parashikimet negative që kanë sjellur edhe shmangie nga aktiviteti i zakonshëm. Te i njëjti frika e intensitetit të mesëm ka vazhduar për tre javë me një prezencë të kohëpaskohshme të frikës, pasigurisë, brengosjes, mërzitjeve, kujtimeve traumatike të rastit dhe mendimeve negative. Po ashtu frikë e intensitetit të ulët ka vazhduar rreth 6 muaj me një prezencë të stresit të tepruar, ndjeshmërisë emocionale, parashikimeve negative dhe disponimit të ulur. Me vetë faktin e ekzistimit të aktgjykimit të plotfuqishëm penal i cili është *res judicata*, prej të cilit vërtetohet forma e fajësisë, e ka bindur gjykatën që duhet ta aprovojë këtë kërkesëpadi. Kjo për faktin se sipas nenit 14 të LPK-së, thuhet se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë në lidhje me dëmin jomaterial, gjykata ka vendosur që këto lëndime trupore të i trajtojë si lëndime të rënda trupore për shkakun se nga ekspertiza e ekspertit ortoped – traumatolog, Dr. Dr. I.S këto lëndime janë kategorizuar si lëndime të rënda trupore. Në këtë rast, gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se shumata e vendosura të jenë një satisfaksion për paditësin dhe se këto shuma janë vendosur në pajtueshmëri të plotë me praktikën gjyqësore. Në këtë rast, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë në emër të dhimbjeve fizike në shumën prej 3.000.00 euro, për shkak se lëndimet e marra nga paditësi, cilësohen si lëndime të rënda trupore, e në bazë të ekspertizës, paditësi dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rënda të cilët kanë zgjatur 15 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të cilët kanë zgjatur për 6 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 3 ditë kohë pas kohe, ndërsa dhimbje fizike e intensitetit të lehtë e cila ka zgjatur 15 ditë. Gjithashtu, gjykata vendosi ta aprovojë kërkesëpadinë në emër të frikës së në shumën prej 2,500.00 euro për shkak se paditësi në momentin e aksidentit ka përjetuar frikë të intensitetit të lartë në dy javët e para pas sulmit, frikë e intensitetit të mesëm ka vazhduar për tre javë, si dhe frikë e intensitetit të ulët e cila ka vazhduar rreth 6 muaj. Baza juridike e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit buron në nenin 183 par.1 të LMD-së, sipas të cilit *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*, ndërkaq sipas nenit 174 të LMD-së përcaktohet që *“Gjykata duke marr parasysh edhe*

*rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues”. Me rastin e vendosjes në lidhje me lartësinë e shpërblimit të dëmit, gjykata kishte parasysh edhe shkallën e dëmit që i është shkaktuar paditësit, ndërsa kjo buron në nenin 183 par.2 të LMD-së, sipas të cilit “Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”. Për të gjitha këto kategori, duke u bazuar në ekspertizat mjekësore, për shpërblimin e dëmit në rastin konkret gjykata ka vendosur sipas çmuarjes së lirë, e kjo duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, sipas të cilit “Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”.*

Gjykata ka vendosur si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se sipas vlerësimit të saj me shumën e aprovuara në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, arrihet satisfaksioni i nevojshëm në lidhje me dëmin që i është shkaktuar paditësit në aksidentin që është objekt i këtij kontesti. Vlerat e aprovuara janë në harmoni të plotë me pritshmërinë e krijuar në rastin konkret, prandaj edhe ka vendosur që ta refuzojë shumën përtej shumës së aprovuar. Me rastin e vendosjes, gjykata pati për bazë shkallën e lëndimit, natyrën e lëndimit, moshën e paditësit që në rastin konkret është i dëmtuar, por që shuma e kërkuar është dukshëm më e lartë nga ajo që gjykata vlerëson se në rastin konkret do të jetë satisfaksion për dëmin e shkaktuar.

Pretendimet e përfaqësuesit të të autorizuarit të të paditurit av. G.Sh, se në rastin konkret shënimet e pacientit nga receta për barna, përveç që shënon terapia “paracetamol tableta” nuk ka konstatim tjetër për pacientin, lidhur me lëndime trupore, siç pretendon pala paditëse, gjykata i vlerëson si pretendime të pa bazuara, pasi që në rastin konkret nga ana e ekspertit është sqaruar, se paditësi ka pësuar lëndimin e buzës dhe thyerjen e dhëmbit, i cili karakterizohet si lëndim i rëndë trupor. Po ashtu pretendimet se ekspertizat nuk janë bazuar në raportin bazë, pasi në raportin bazë kemi të bëjmë me lëndime të lehta trupore, ndërsa në konstatimet e ekspertizës kemi të bëjmë me lëndime trupore të rënda, si dhe deri te konstatimi si në ekspertizë, ka ardhur sipas dy raporteve, ndërsa në fakt ato janë receta për barna, po ashtu nuk dihet se nga kush janë lëshuar raportet bazë, gjegjësisht a janë institucionet shtetërore apo janë ordinanca private, si dhe me pretendime se kemi të bëjmë me prova që janë kontradiktore, gjykata po ashtu e vlerëson si pretendime të pabazuara, pasi që në konstatimet në ekspertizë dhe sqarimeve të ekspertit të dhëna në seancën e shqyrtimit kryesor është sqaruar se humbja e një dhëmbi është 1% zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm mjekësor dhe ky lëndim karakterizohet si lëndim i rëndë trupor, sipas rregullores së BQK-së, ku edhe është bazuar mendimi i dhënë në ekspertizë, po ashtu raporti i datës 29.08.2020 nuk quhet recetë, siç pretendon pala e paditur, por është raport i mjekut specialist nga H në Rahovec, me logo të institucionit, datë dhe nënshkrim të mjekut, e të cilat janë kushtet që sipas BQK-së, që duhet të bazohet ekspertiza, qoftë institucion shtetëror ose privat, por i licencuar.

Gjykata ka analizuar edhe provat tjera dhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me lartësinë e kamatës është marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136 par. 1, nenit 174 si dhe nenit 382 të LMD-së, por edhe të nenit 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që i padituri t'ia kompensojë paditësit shumën si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që i referohen përpilimit të padis në shumë prej 104.00 euro, taksës gjyqësore në shumë prej 21.00 euro, për dy seanca të mbajtura nga 135.20 euro për seancë, ndërsa për një seancë që nuk është mbajtur 50%, të shumës 135.20 euro, dhe atë shumën prej 67.60 euro, apo të gjitha seancat shumën prej 338.00 euro, si dhe për ekspertizat shumën prej 300.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 763.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.506/2020, më datë 21.05.2024

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.